

VENDIM
Nr.225, datë 24.5.1997

PËR KALIMIN E INDUSTRISE SË BAKRIT NË REGJIM TË PËRKOHSHËM
KONSERVIMI

Me propozimin e Ministrisë së Burimeve Minerare dhe Energjetike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Industria e bakrit të kalojë në regjim të përkohshëm konservimi. Fondet të përballohen nga fondet e konservimit të miratuara për vitin 1997 për Ministrinë e Burimeve Minerare dhe Energjetike, si dhe duke shtuar këtë zë për 12 milionë lekë nga pakësimi i investimeve për sektorin e gjeologjisë.

2. Punonjësit që do të dalin të lirë nga konservimi i përkohshëm i ndërmarrjeve përbërëse të industrisë së bakrit, të trajtohen e të paguhen në bazë të kriterëve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.420, datë 15.8.1994 “Për pagesën e punonjësve që dalin të tepërt nga procesi i ristrukturimit ose mbylljes së ndërmarrjeve apo pjesëve përbërëse të tyre, në vartësi të Agjencisë së Ristrukturimit të Ndërmarrjeve , si dhe të disa ndërmarrjeve të tjera shtetërore me kushte të vështira për vazhdimin e mëtejshëm të veprimtarisë së tyre”, si dhe ndryshimeve të bëra me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.649, datë 23.9.1996 dhe udhëzimeve përkatëse me këtë ndryshim:

“Përfitojnë nga ky vendim punonjësit e këtyre sektorëve që dalin të papunë nga data 1.6.1997 deri në datën 1.7.1997. Nevojat për fonde financiare të përballohen nga fondet e akorduara për vitin 1997 Ministrisë së Privatizimeve për ARN”.

3. Me fillimin e punës gjithë punëtorët që do të trajtohen sipas pikës 2 të këtij vendimi, do të kthehen në punë.

4. Afati i mbylljes tërësore të disa minierave të bakrit që përcakton pika 3 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.617, datë 6.11.1995 “Për mbylljen tërësore të disa minierave të bakrit”, shtyhet për vitin 1998. Fondet e përcaktuara për mbylljen e këtyre minierave për vitin 1997 kalojnë për konservimin e industrisë së bakrit.

5. Duke u bazuar në nenin 12 të ligjit nr.8222, datë 14.5.1997 “Për Buxhetin e Shtetit për vitin 1997”, ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Burimeve Minerare dhe Energjetike, të bëjnë ndryshimet sipas pikës 1 të këtij vendimi.

6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Burimeve Minerare dhe Energjetike, Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale dhe Ministria e Privatizimeve.

7. Ministria e Burimeve Minerare dhe Energjetike, brenda muajit qershor të vitit 1997, të paraqesë në Këshillin e Ministrave platformën për ecurinë e mëtejshme të industrisë së bakrit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtin efektet nga data 1.4.1997.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino